ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KVENDI KOMUNAL-GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-20-5049-4-2-3**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan**

ANKESË

Kundër VENDIMIT dt.29.10.2020 të marrë nga Njësia e Prokurimit K. Gjilan me Nr. të Prokurimit GI 651-20-5049-4-2-3

1. Identifikimi i ankuesit*

ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr."Astrid Bytyqi" Ferizaj
(Adresa)

Ferizaj — **700000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

045412915 — **811275719**
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

AGON QOSA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ateleaskulptures_agonaqosa@hotmail.com
(Adresa elektronike)

05.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE Sh.p.k. AGON QOSA

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 902/20
Datë/Datum. 09.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Av. Ma. Sc. Burhan Qosa

(Emri i avokatit)

Rr."Salih Çeku" p.n. Ferizaj
(Adresa e plotë)

044466526
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

b.qosa@hotmail.com
(Adresa elektronike)

AVOKAT - LAWYER
Ma.Sc. BURHAN QOSA
044 466 526 - FERIZAJ

05.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Autoriteti Kontraktues (AK) është: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN***
DOSJA E KONKURSIT TE PROJEKTIMIT
*Data e përgatitjes së dosjes së konkursit projektues **07.09.2020***
*Nr, i prokurimit **651-20-5049-4-2-3***
Titulli: Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilani.

Dosja e konkursit të Projektimit dt.07.09.2020
Shpallja e procedurës në e-prokurim (09.09.2020);
Dorëzimi i tenderit:(28.09.2020 ora 14:00);
Hapja e ofertës:(28.09.2020 ora 14:00);
Njoftimi përmes Letrës Standarde: (23.10.2020);
Njoftimi mbi vendimin e AK –së: (23.10.2020),
Kërkesa për Rishqyrtim dt.27.10.2020
Vendimi mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit dt.28.10.2020
Njoftimi për kërkesën për rishqyrtim dt.29.10.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK –së i korrigjuar i dt.23.10.2020),
VENDIMI dt.29.10.2020, Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-1

4. **Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po					Jo	X	

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK:

Autoriteti Kontraktues me rastin e vendosjes si në Njoftimin Mbi Vendimin e dt.23.10.2020, atë të korrigjuar më dt.29.10.2020, si dhe VENDIMI dt.29.10.2020, Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-3, vërtetohet se si **autoritet kontraktues ka vepruar në kundërshtim jo vetëm me:**

- **Nenin 1 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës;**
- **Nenin 7 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës ;**
- **Nenin 51 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës;**
- **Nenin 52 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës;**
- **Nenin 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës:**
- **Nenin 80 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 23.1 të Dosjes së Konkursit të Projektimit:**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankuesi – Operatori Ekonomik **ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K., me pronar Skulptorin Agon Qosa, me anë të kësaj ankese për ORGANIN SHQYRTUES I PROKURIMIT (OSHP)**

DEKLARON

I. Se si Operator Ekonomik ka qenë ofertues në Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-20-5049-4-2-3 të** Autoritetit Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan në tenderin **për ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan,** në të cilin aktivitet Kodi i tij ishte 8888 i cili është i vendosur edhe në BUCETËN e tij, si dhe në shkresat tjera të lëndës që do ti bashkëngjiten si prova kësaj ankese.

II. Si Operator Ekonomik nga Autoriteti Kontraktues –Kuvendi Komunal Gjilan, lidhur me tenderin në fjalë ka pranuar Njoftimin Mbi Vendimin e dt.23.10.2020, nga i cili njoftim vërtetohet se AK-ja:

- Ofertën Teknike të OE *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K* me seli në Ferizaj Rr."Astrit Bytyqi" p.n. e ka vlerësuar me 80 pikë apo 80%, e po ashtu
- Ofertën Financiare të OE *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K* me seli në Ferizaj Rr."Astrit Bytyqi" p.n. e ka vlerësuar me 20 pikë apo në përqindje 20%.

Kurse

Tek kolona e atij njoftimi ku vendosen pikët totale ankuesi Agon Qosa, ka vërejtur se i janë vendosur 52.98 % apo 52.98 pikë, përllogaritje kjo e cila nuk ishte në përputhje nenit 23.1 të Dosjes së Konkursit të Projektimit, i cili nen përcakton çartë Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemimin e pikëve i cili duhej përdorur nga AK, për vlerësimin e Koncept Projekteve –BOCETËS,

III. Parashtruesi i kësaj ankese të OE *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K* me seli në Ferizaj Rr."Astrit Bytyqi" p.n. respektivisht pronari-Skulptori Agon Qosa, duke qenë i bindure se BUCETA e tij e dorëzuar në atë tender si Ofertë Teknike ishte shumë më e mirë për të mos thënë e pa konkurrent në raport me dy Ofertë Teknike të tjera të cilët i kishin sjellë

Operatorët Ekonomik me kodin 3333 dhe 6666, e që në raport me Ofertën Teknike të Operatortt Ekonomik me kodin 6666 mjafton të shikojnë njerëzit laik në këtë fushë dhe do ta vlerësojnë me syrin e thjesht se Ofertë Teknike me kodin 8888 është e diametralisht e dukshme se është shumë më e mirë se Ofertë Teknike me kodin 6666, dhe me që këtë të fundit , respektivisht Operatorin Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan, Autoriteti Kontraktues –Kuvendi Komunal Gjilan e kishte shpërblyer me kontratë për ndërtimin e skulpturës së shtatores kushtuar **Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan**, ankuesi Operatorit Ekonomik *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K.*, më dt. 27.10.2020 ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-20-5049-4-2-3.**

Provë: Kërkesa për Rishqyrtim e dt. 27.10.2020.

IV. Pas Kërkesë për Rishqyrtim, Autoritetit Kontraktues –Kuvendi Komunal Gjilan, Operatorit Ekonomik *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K.*, i është përgjigjur përmes E-mailit me titullin Njoftimi për Kërkesën për rishqyrtim dt.29.10.2020, me të cilin njoftim AK, është arsyetuar se kinse AK ka bërë gabim teknik në Njoftimin Mbi Vendimin e dt.23.10.2020, dhe se çuditërisht AK e ka edhe pse sipas saj e pas Kërkesës për Rishqyrtim dt.29.10.2020, e korrigjuar Njoftimin Mbi Vendimin e dt.23.10.2020 por njoftimi i korrigjuar prapë mbanë datën dt.23.10.2020, e po ashtu vlen të theksohet se po më dt.29.10.2020, Ankuesit AK-ja i ka dërguar edhe VENDIMIN Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-1 ndaj të cilit tani ankuesi parashtron këtë ankesë në OSHP.

V. Pas pranimit të VENDIMI dt.29.10.2020, Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-1, parashtruesi i kësaj ankese, njofton OSHP-n, se fillimisht skulptori AGON QOSA fizikisht ka shkuar pran Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan, ku nga këta të fundit, ka kuptuar se në përbërjen e Komisionit Vlerësues në Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-20-5049-4-2-3**, kanë qenë tre anëtarë-profesor koleg të **Skulptorit Sabri Shaqiri nga Gjilani,** përfaqësues i Operatorit Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan, ku dhe me ta kuptuar nga ana e parashtruesit të kësaj ankese, se Komisioni Vlerësues në Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-20-5049-4-2-3** ka qenë në përbërje të **Adem Rusinovcit (Skulptor) - Kryetar i Komisionit**; **Mehmet Behluli (Piktor) Anëtar dhe Genc Rezniqi (dizajner) anëtar**, parashtruesi i kësaj ankese **Skulptori Agon Qosa**, e ka kuptuar se pse në rastin konkre Autoriteti Kontraktues –Kuvendi Komunal Gjilan, e kishte shpërblyer me kontratë për ndërtimin e skulpturës së shtatores kushtuar **Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan** Operatorin Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan, edhe për kundër asaj se ky OE, kishte Ofertën Teknike më e dobëtën e po ashtu Ofertën Financiare më të lartën.

VI. Parashtruesi i kësaj ankese, OE ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K respektivisht pronari-Skulptori Agon Qosa, me anë të kësaj ankese njofton OSHP-n, se përbërja e Komisionit Vlerësues, respektivisht

anëtarët e ati komisioni si:

- Adem Rusinovcit (Skulptor) - Kryetar i Komisionit;
- Mehmet Behluli (Piktor) Anëtar; dhe
- Genc Rezniqi (dizajner) anëtar.

➢ Janë koleg dhe shokë të punës të skulptorit Sabri Shaqiri në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Arteve, dhe si koleg kanë qenë në dijeni të plotë paraprakisht , se skulptori Sabri Shaqiri drejtor i Operatorin Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan, kishte Ofertuar me KODIN 6666, në tenderin për ndërtimin e skulpturës së shtatores kushtuar **Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan,** dhe se pa dyshim Anëtarët e Komisionit Vlerësues duke qenë koleg dhe shokë të punës me Skulptorin Sabri Shaqiri drejtor i Operatorin Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan, komisioni e kishte vlerësuar BUCETEN e këtij të fundit me KODIN 6666 si më të mirën, edhe pse ajo ofertë nga syri një laiki, del të jetë jo konkurruese me Ofertën Teknike të ankuesit - Skulptorit Agon Qosa, nga dhe ky i fundit, mbi këtë bazë është i bindur se Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan, Njoftimin Mbi Vendimin e dt.23.10.2020 përfshirë edhe atë të korrigjuar si dhe VENDIMIN Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-1 e ka nxjerrë në kundërshtim dispozitat ligjore nga **Nenin 1, 7, 51, 52, 59 dhe 80 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës,** pasi që në kundërshtim me këto dispozita Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan, fillimisht e ka zgjedhur përbërjen e Komisionit Vlerësues e më pastaj anëtarët e këtij komisioni, po ashtu duke vepruara në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura si më lartë, si dhe në mundësinë për ti shfrytëzuar kompetencat e tyre me qëllim që shoku i tyre të përfitoj materialisht, këtij të fundit ja kanë vlerësuar si më të mirën Ofertën Ekonomike dhe atë Financiare në tenderin për **ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan,** edhe në kundërshtim me **nenin 23.1 të Dosjes së Konkursit të Projektimit.**

- Parashtruesi i kësaj ankese t OE ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K për ti vërtetuar të cekurat më lartë për OSHP-n, kësaj ankese i bashkëngjit nga tri foto të bëra të BUCETAVE në vendin e ngjarjes pra tri foto të BUCETËS së ankuesit që mban KODIN, 8888 si dhe tri foto të BUCETËS së Operatorin Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan me KODIN 6666

Provë: nga tri foto të BUCETAVE të cekura më lartë.

Parashtruesi i kësaj ankese është i bindur se paneli i OSHP-së, nga momenti kur ti merr në shikim fotot e lartcekura do të bindet se ankesa e parashtruesit është e bazuar në ligj për faktin se mjafton që ato foto të bucetave të krahasohen në mes tyre, për të dal në përfundimin se vërtetë në rastin konkret se Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan, Njoftimin Mbi Vendimin e dt.23.10.2020 përfshirë edhe atë të korrigjuar si dhe VENDIMIN Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-1 e ka nxjerrë në kundërshtim dispozitat ligjore **Nenin 1 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës të cilat thonë:**

Neni 1
QËLLIMI i
I Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Që do të thotë se nga vet fotot OSHP, do të vjen në përfundim se në rastin konkret, ashtu siç dhe si ka vendosur dhe vlerësuar Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan dhe Komisioni vlerësues ta nderojnë **skulpturën së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan,** të njëjtit me një vendosje të tillë për veç se hapur **NUK KANË** vendosur mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ata po ashtu kanë vu në pah mos integritetin dhe përgjegjësinë e tyre si zyrtarëve publik.

NENI 7
i Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.
Që do të thotë se mjafton të cekurat më lartë dhe fotot e propozuara për ta kuptuar se në rastin konkret Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan dhe Komisioni vlerësues ta nderojnë **skulpturën së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan, duke shkelur hapur dhe me qëllim dispozita ligjore nga par. 1 dhe 2 të Nenin 7 51,52,59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 23.1 të Dosjes së Konkursit të Projektimit**

NENI 80

i Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës

Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

1. Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të jurisë duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.
2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.

Që do të thotë se, shikuar nga fakti se në përbërjen e Komisionit Vlerësues në rastin konkret Autoriteti Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan dhe Komisioni ka caktuar vetëm një skulptor, vërteton faktin se në këtë rast procedurat e prokurimit janë bërë në kundërshtim jo si kërkohet me dispozitat ligjore nga neni 80 par 1 i LPP ku për pasoj JURIA (komisioni Vlerësues), përveç se i ndikuar, nuk ka qenë adekuat në përbërjen e tij për të vendosur ashtu siç kërkohet me nenin 80 par.2 të LPP lidhur me **nenin 23.1 të Dosjes së Konkursit të Projektimit.**

Për ti vërtetuar të cekurat më lartë edhe në kuptimin shkencor, parashtruesi i kësaj ankese për OSHP-n, si provë materiale ankesë i bashkëngjitë 5 fletë A4 me foto dhe atë :

- dy fletë A4 në përbërje me 6 foto të Kanunit të përmasave të Poliklitit, (Doryphoros POLYKLEITOS) DHE (Lysipps-Apoxymenos) të njohura ndërkombtarisht të krahasueshme me Ofertën teknike (Bucetës) me KODIN 8888 të për shkruar si në foto, dhe
- një foto shkencore lidhur me proporcionet e njeriut shtatshkurtër e krahasueshme me foton e bucetës të Operatorit Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan me KODIN 6666,

  nga të cilat prova OSHP, do të konstatoj se **skulptura e shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan, nga** Operatori Ekonomik "ONIX-S" sh.p.k., Gjilan, oshtë ofertuar për tu ndërtuar me përpjestushmërin shkencore të bazuar në proporcionet e njeriut shtatshkurtër, çka rezulton çartë se BUCETA FITUESE është në kundërshtim me vet PROPORCIONET e Heroit Kadri Zeka kur ai ishte gjallë, për të cilin fakt OSHP-së me këtë ankesë ankuesi i bashkëngjitë edhe 9 foto të Heroit Kadri Zeka.

Nga të cekurat më lartë dhe provat e propozuara, Ankuesi – Operatori Ekonomik **ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K.**, me

pronar Skulptorin Agon Qosa, KËRKON **që OSHP-ja, duke vepruar konform dispozitave të nenit 17 par. 7, 8,9,10,11, 12, nenit 18 par.1, nenit 21, 22, 23,24, 25, 30 dhe 31 të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe në kuptim të nenit 1, 7 51,52,59 dhe 80 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 23.1 të Dosjes së Konkursit të Projektimit të pas administrimit të të gjitha provave veç e veç dhe së bashku në tërësi OSHP, të bjerë këtë :**

VENDIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e OE *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K* me seli në Ferizaj Rr."Astrit Bytyqi" p.n., me drejtor AGON QOSA-Skulptor.

ANULOHET Njoftimi Mbi Vendimin e dt.23.10.2020, Njoftimi i korrigjuar më dt.29.10.2020, si dhe VENDIMI dt.29.10.2020, Nr. të Prokurimit Gl 651-20-5049-4-2-3 i Autoritetit Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan për **ndërtimin e skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan.**

SHPËRBLEHET me Kontratë për **ndërtimin e skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilan,** Operatori Ekonomik *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K* me seli në Ferizaj Rr."Astrit Bytyqi" p.n., me drejtor AGON QOSA-Skulptor.

DETYROHET Autoritetit Kontraktues –Kuvendit Komunal Gjilan, që Operatorit Ekonomik *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K* , të ja kompensoj dëmin material dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 5,500.00 euro.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Sa i përket dëmit material, ankuesi Operatori Ekonomik *ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA SH.P.K, me kodin 8888, lartësinë e dëmit dhe shpenzimet procedurale për OSHP-n do të precizoj saktësisht me parashtresë të veçantë*

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

1. Dosja e konkursit të Projektimit dt.07.09.2020
2. Shpallja e procedurës në e-prokurim (09.09.2020);
3. Dorëzimi i tenderit:(28.09.2020 ora 14:00);
4. Hapja e ofertës:(28.09.2020 ora 14:00);